

**LIGJ**  
**Nr.7583, datë 13.7.1992**

**PËR KOMPETENCAT PËR CAKTIMIN E PAGAVE TË PUNËS**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI POPULLOR**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

**Neni 1**

Paga përfaqëson të ardhurat në para, që punëdhënësi i jep punëmarrësit për punën e kryer në sasi, cilësi e në kohë, dhe përcaktohet në kontratën e punës, që lidhet ndërmjet punëdhënësit dhe të punësuarit.

**Neni 2**

Në Republikën e Shqipërisë kompetencë për caktimin e pagës sipas përkatësisë kanë:

- Këshilli i Ministrave;
- ministritë dhe institucionet e tjera qendrore dhe organet e pushtetit lokal;
- ndërmarrjet shtetërore dhe institucionet shtetërore jobuxhetore;
- personat e tjerë juridikë a fizikë, vendas ose të huaj.

**Neni 3**

Këshilli i Ministrave cakton pagën minimale mujore në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person juridik a fizik, vendas ose i huaj.

**Neni 4**

Këshilli i Ministrave përcakton pagën mesatare mujore sipas ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore për ndërmarrjet shtetërore, institucionet shtetërore jobuxhetore ose pjesërisht jobuxhetore që ato kanë në vartësi.

Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, në bazë të kësaj page, përcaktojnë pagën mesatare mujore për çdo ndërmarrje shtetërore, institucion shtetëror jobuxhetor ose pjesërisht jobuxhetor, duke ruajtur në shkallë ministrie pagën mesatare mujore të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave.

**Neni 5**

Ndërmarrja shtetërore, institucioni shtetëror jobuxhetor ose pjesërisht jobuxhetor i caktojnë vetë pagat e punës në varësi nga mundësitë financiare të tyre, duke ruajtur në shkallë ndërmarrjeje, institucioni shtetëror jobuxhetor ose pjesërisht jobuxhetor pagën mesatare mujore të përcaktuar nga ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, nga të cilat varen.

**Neni 6**

Këshilli i Ministrave përcakton:

- Pagat e titullarëve për organet e larta, shtetërore, institucionet e tjera qendrore dhe pagat e personave të tjerë të barazuar me ta.
- Numrin e klasave, kufijtë e madhësisë së pagës dhe shtesave mbi pagë sipas klasave për punonjësit e aparateve të organeve të larta shtetërore, të institucioneve të tjera qendrore, të organeve të

pushtetit lokal, si dhe të institucioneve buxhetore dhe pjesërisht buxhetore në varësi të ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore.

- Kompetencat e organeve të larta shtetërore, të institucioneve të tjera qendrore dhe të organeve të pushtetit lokal në fushën e pagave.

#### Neni 7

Këshilli i Ministrave miraton rritjen e pagës mesatare mujore, në përqindje, për ndërmarrjet shtetërore, institucionet jobuxhetore, dhe pjesërisht jobuxhetore, si dhe rritjen në përqindje të fondit të pagave për organet e larta shtetërore, institucionet e tjera qendrore dhe organet e pushtetit lokal.

#### Neni 8

Ministria e Financave dhe e Ekonomisë ushtron kontroll mbi rritjen e pagës mesatare mujore në ndërmarrjet shtetërore, institucionet shtetërore jobuxhetore dhe pjesërisht jobuxhetore.

- Nëse ndërmarrja shtetërore, institucioni shtetëror jobuxhetor dhe pjesërisht jobuxhetor rritin pagën mesatare mujore deri në 5 % mbi masën e rritjes në përqindje të miratuar nga Këshilli i Ministrave në shkallë vendi, nuk zbatohet asnjë sanksion.

- Nëse ndërmarrje shtetërore, institucioni shtetëror jobuxhetor dhe pjesërisht jobuxhetor rritin pagën mesatare mujore mbi 5 % deri në 8 % mbi masën e rritjes në përqindje të miratuar nga Këshilli i Ministrave, detyrohen të derdhin në buxhetin e shtetit një pjesë të fitimit, baras me 100 % të kësaj rritjeje.

- Nëse ndërmarrja shtetërore, institucioni shtetëror jobuxhetor dhe pjesërisht jobuxhetor rritin pagën mesatare mujore mbi 8 % deri 10 % mbi masën e miratuar në përqindje nga Këshilli i Ministrave, detyrohen të derdhin në buxhetin e shtetit një pjesë të fitimit, baras me 200 % të kësaj rritjeje.

- Nëse ndërmarrja shtetërore, institucioni shtetëror jobuxhetor dhe pjesërisht jobuxhetor rritin pagën mesatare mujore mbi 10 % mbi masën e miratuar në përqindje nga Këshilli i Ministrave, detyrohen të derdhin në buxhetin e shtetit një pjesë të fitimit baras me 500 % të kësaj rritjeje.

Për ndërmarrjet shtetërore dhe institucionet shtetërore jobuxhetore, veprimtaria e të cilave është me humbje. Këshilli i Ministrave cakton rregulla të veçanta për kufizimin e pagave.

Sanksionet e parashikuara në këtë nen jepen nga inspektorët e seksionit të financës në rreth.

Kundër vendimit mund të bëhet ankim, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes së njoftimit të tij, te përgjegjësi i Seksionit të Financës në rreth dhe kundër vendimit të këtij të fundit mund të bëhet ankim, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes së njoftimit të tij, tek drejtori i Pagave e Çmimeve në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, akti i të cilit është i formës së prerë.

#### Neni 9

Në qoftë se ndërmarrja shtetërore, institucioni shtetëror jobuxhetor, dhe pjesërisht jobuxhetor rritin pagën mesatare mujore mbi 15 % kundrejt masës në përqindje të miratuar nga Këshilli i Ministrave, përveç sanksioneve të mësipërme, merren masa deri edhe në shkarkimin e drejtorit të Këshillit Drejtues të ndërmarrjes shtetërore, të drejtuesit të institucionit shtetëror jobuxhetor dhe pjesërisht jobuxhetor.

#### Neni 10

Ligji nr.5839, datë 20.3.1979 "Për përcaktimin e raporteve të pagave të nëpunësve në krahasim me ato të punëtorëve dhe të kooperativistëve", si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

#### Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi 1 muaj pas shpalljes.

**Shpallur me dekretin nr.253, datë 17.7.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.**